



Agjencia për
Mbështetjen
e Shoqërisë Civile

RAPORT I ZGJERUAR VJETOR

2024

Adresa:

Rruga "Frosina Plaku",
Nr. 58, Kati II,
Tiranë, Shqipëri

Telefon:

04 22 355 69

E-mail:

info@amshc.gov.al

Website:

www.amshc.gov.al



Agjencia për Mbështetjen
e Shoqërisë Civile

RAPORT MBI VEPRIMTARINË E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE GJATË VITIT 2024

Tabela e përmbajtjes:

KAPITULLI I

- Vështrim i përgjithshëm 3
- Organet dhe funksionet e institucionit **Error! Bookmark not defined.**
- Kuadri ligjor organizimi strukturor dhe funksionimi i AMShC-së 4

KAPITULLI II..... Error! Bookmark not defined.

- Zbatimi i Ligjit "Për të Drejtën e Informimit" ,Ligjit "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik... si dhe Strategjisë Kundër Korrupsionit... 6- 7
- Analiza dhe statistika të shpërndarjes së granteve të Thirrjes 14 sipas fushave prioritarë si dhe shtrirjes territoriale..... 7-14
- Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese 14-17

KAPITULLI III 6

- Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) 18-19

KAPITULLI IV 18

- Monitorimi/Vlerësimi i performancës së treguesve Buxhetore për Vitin 2024**Error! Bookmark not defined.**
- Plani fillestar i Buxhetit Viti 2024 21-24
- Rishikimi i Buxhetit
- Vitin 2024 si dhe ndryshimet e ndodhura nga plani fillestar 25
- Analiza e realizimit të treguesve buxhetorë për Vitin 2024 32

KAPITULLI V 33

- Aktivitetet kryesore të AMShC-së për vitin 2024 33-45

KAPITULLI VI 45

- Bordi Mbikqyrës..... 45

KAPITULLI I

Vështrim i përgjithshëm

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, është një ent publik, buxhetor krijuar me Ligjin me nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

AMShC-ja është krijuar me qëllimin për të asistuar me Mbështetje Financiare dhe Teknike Shoqërinë Civile në vend duke qenë e përkushtuar të promovojë, mbështesë dhe mbrojë parimet e dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë, mos-diskriminimit, sundimit të ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut, transparencës dhe profesionalizmit.

Një shoqëri civile aktive, e fuqishme dhe gjithë përfshirëse mund të luajë një rol të rëndësishëm për zbatimin në praktikë të këtyre parimeve. Ajo është gjithashtu një komponent thelbësor i çdo demokracie funksionale.

Duke artikuluar shqetësimet e qytetarëve, organizatat e shoqërisë civile, si subjekte jo-shtetërore, struktura jo-fitimprurëse, në të cilat njerëzit organizohen të ndjekin objektivat dhe idealet e përbashkëta, duhet të jenë gjithnjë e më shumë aktivë për çështje publike si dhe të angazhohen në iniciativa që nxisin pluralizmin dhe pjesëmarrjen në demokraci.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në kuadër të politikës së fuqizimit të shoqërisë civile, është përqendruar në stimulimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe gjithë përfshirëse.

Kjo reflektohet në përpjekjet për krijimin e një mjedisi që është i favorshëm për aktivitetet e shoqërisë civile dhe ndërtimin e kapaciteteve të OJF-ve për të qenë aktorë të efektshëm, të përgjegjshëm dhe të pavarur, nëpërmjet formalizimit të procedurave transparente dhe jo-diskriminuese të regjistrimit, veprimtarisë së lirë dhe të pavarur, si dhe bashkëpunimit midis qytetarëve etj.

Shoqëria civile, duke pasur struktura të përshtatshme dhe mekanizma për bashkëpunim me AMShC-në dhe institucionet e tjera publike, si dhe fluks të lirë, të qartë dhe të arritshme të informacionit mbi çështjet e interesit publik përmes mekanizmave të qëndrueshme dhe të strukturuar, rrit autonominë e saj, atë të përfaqësimit dhe të llogaridhënies, duke forcuar bazën e organizatave sipas standardeve më të larta të qeverisjes së brendshme, nëpërmjet përfshirjes së strukturave demokratike, monitorimit dhe vlerësimit, menaxhimit financiar, transparençës, informimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

Organet dhe funksionet e institucionit

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile është krijuar me Ligjin nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” dhe ka si mision të saj, nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile, në të mirë dhe në interes të publikut. Për përmbushjen e këtij misioni, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka si detyrë të saj funksionale që të ofrojë asistencë financiare dhe teknike për programet që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse; bashkëpunimin ndër-sektorial e ndërkombëtar; nismat civile; filantropi; vullnetarizmin e institucioneve demokratike të shoqërisë civile; si dhe programe të tjera, që lehtësojnë përmbushjen e misionit të saj.

Agjencia Për Mbështetjen E Shoqërisë Civile ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- nxitjen e bashkëpunimi me OJF-të, që kanë objekt të punës mbikëqyrjen e luftës kundër korrupsionit; luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore e të trajtimit të viktimave të saj; kundër dhunës në familje e kundër dhunës ndaj fëmijëve;
- nxitjen e qytetarëve në veprimtari, përfshirja e pjesëmarrja e tyre për zhvillimin e komunitetit;
- respektimin e të drejtave të njeriut;
- krijimin e konsolidimin e kapaciteteve të shoqërisë civile;
- zhvillimin e bashkëpunimit ndër sektorial dhe e bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile;
- rritjen e ndikimit publik dhe veprimtarisë së organizatave të shoqërisë civile në vendimmarrje;
- zhvillimin e sipërmarrjes shoqërore dhe punësimit në sektorin jofitimprurës;
- rritjen e ndikimit të shoqërisë civile në proceset e hartimit dhe të miratimit të politikave publike
- përcaktimin e procedurave të zbatueshme për shpërndarjen e fondeve në mbështetje të shoqërisë civile etj

Kuadri ligjor, organizimi strukturor dhe funksionimi i AMShC-së

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile funksionon dhe mbështet punën e saj duke u bazuar në një paketë të plotë ligjore, si vijon:

a) Ligji me nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Ky ligj, deri më sot nuk ka pësuar asnjë ndryshim.

b) Vendimi nr. 769 datë 15.07.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

c) Vendimi nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

ç) Rregullorja e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, miratuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës.

dh) Rregullorja “Mbi procedurat e Financimit me Grante në Mbështetje të Shoqërisë Civile” të miratuar nga Bordi Mbikëqyrës me Vendimin nr. 1 datë 19/02/2024

f) Udhëzimin nr. 1 datë 29.12.2010 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile “Për plotësimin e raporteve financiare dhe kontrollin financiar, për efekt të monitorimit të Projekteve të financuara me Grante nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

g) Urdhri nr. 161 datë 05.09.2013 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile “Për procedurën e administrimit të akteve shkresore, kërkesave/projekt-propozimeve, formimin e dosjeve dhe mënyra e qarkullimit të tyre në AMShC”.

KAPITULLI II

❖ **STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2024 – 2030**

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), është pjesë e zbatimit të Objektivave të Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030.

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) AMSHC-ja ka fut si prioritet të dedikuar Prioritetin :Lufta kundër Korrupsionit dhe Edukimi Ligjor i Publikut dhe SKZHI: (detyrim strategjik 20% ,10%, 10% e fondit që do shpërndahet)

Ky prioritet është në kuadër pikërisht në kuadër të detyrimeve që vijnë nga marrveshjet ndër-institucionale të tilla si Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

Ne lidhje me zbatimin e këtij angazhimi nga të dhënat statistikore lidhur me projektet në fazën e aplikimit; projektet që kanë aplikuar për këtë prioritet kanë qenë në masën gati 4 % ; në përqindje kjoje vogël për të përmbushur detyrimin min 10% ; gjithsesi

AMSHC-ja do të shtojë angazhimin në Thirrjen e radhës për të përmbushur detyrimin e arritjes së këtij objektiv; pra të projekteve të shpërndara me fokus fushën e luftes kundër korrupsionit nepermjet; rritjes së ndergjegjesimit e intensifikimit të takimeve; organizimeve me aktoret e shoqërisë civile me fokus temën e luftes kundër korrupsionit"

❖ **ZBATIMI I LIGJIT "PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT" SI DHE I LIGJIT "PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK"**

Zbatimi i Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është përgatitur programi i transparencës për Agjencinë e Mbështetjes së Shoqërisë Civile.

Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës AMSHC ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale.

Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet.

Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë të përmbajtje.

Faqja zyrtare e AMSHC-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm.

Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve / subjekteve të të dhënave, etj.

Zbatimi i Ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

Takime informuese dhe konsultime publike me OShC-të lidhur me çështjet:¹

- *Në qaret kryesore të vendit lidhur me:*
 - *Mbi procesin e përcaktimit të prioriteteve të Thirrjes nr. 17 për Projekt-Propozime*
 - *Mbi procesin e përzgjedhjes së katër anëtarëve të rinj të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile*
 - *Takime Konsultative mbi sfidat e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile në Shqipëri*

❖ **ANALIZA DHE STATISTIKA TË SHPËRNDARJES SË GRANTEVE TË THIRRJES 17 SIPAS FUSHAVE PRIORITARE SI DHE SHTRIRJES TERRITORIALE**

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadrin e konkurimit të hapur dhe transparent sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10 093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në përputhje me statutin dhe misionin e saj: Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut; shpalli këtë Thirrje për Shprehje Interesi; Thirrjen e radhës për të gjitha OJF-të e interesuara për projekte.

Prioritet e përcaktuara nga Bordi Mbikqyrës për Thirrjen (Nr.17) (23 shkurt - 25 Mars 2024) ishin si më poshtë:

1- Forcimi i drejtësisë dhe llogaridhënies: qasje novatore në monitorimin e reformës në drejtësi dhe rritjen e rolit të mediave investigative në luftën kundër korrupsionit.

- a. Korrupsioni dhe lufta kunder tij.
- b. Monitorimi i Reformës në Drejtësi dhe procesit të Vettingut.
- c. Mbështetje për median investigative lokale.

2- Fuqizimi i Gjeneratës së ardhshme: Nxitja e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve përmes promovimit të talenteve artistike, integritit në komunitet, vullnetarizmit dhe ndërgjegjësimit për shëndetin seksual.

- a. Mbrojtja e të drejtave të femijëve dhe të rinjve .
- b. Bashkëveprimi i rinisë në fushatat sensibilizuese për promovimin e talenteve të reja në art dhe trashëgimi kulturore .
- c. Aktivizimi i të rinjve në proceset integruese, vullnetarizmi dhe filantropia.
- d. Sensibilizimi i të rinjve për marrëdhënie të mbrojtura dhe të shëndetshme seksuale.

3- Rritja e mirëqenies së komunitetit përmes qeverisjes lokale gjithëpërfshirëse: Forcimi i qeverisjes vendore, edukimi profesional dhe shërbimet sociale për gratë, të rinjtë, të moshuarit, minoritetet dhe njerëzit me aftësi të ndryshme.

- a. Mirëqeverisja vendore.
- b. Mbështetje për arsimimin profesional, fuqizimin dhe punësimin e grave e të rinjve.
- c. Përmirësimi i shërbimeve sociale.
- d. Mbështetje për moshën e tretë, ofrimi i shërbimeve sociale në banesë, etj.
- e. Mbështetja e minoriteteve, regjistrimi i fëmijëve rom në regjistrat e Gjendjes Civile.

¹ Në mënyrë më të detajuar i gjeni në kapitullin IV

f. Mbështetje dhe aksesueshmëria për personat me aftësi ndryshe, përfshirja sociale e personave me aftësi intelektuale.

4- Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Mbrojtja e Mjedisit: Rritja e Zonave Natyrore Rajonale për Turizmin, Mbështetja e Ruajtjes së Pyjeve dhe Burimeve Termale, Promovimi i Turizmit Familjar me fokus në produktet tradicionale përballë kërcënimit të zhvillimit ekonomik.

a. Identifikim, adresim dhe zhvillim të zonave rajonale natyrore me potenciale turistike të riskuara nga zhvillimet ekonomike të pakontrolluara.

b. Mbështetja e projekteve për mbrojtjen e mjedisit me fokus pyjet dhe vendburimet termale; Fokusim dhe adresim i dëmeve të shkaktuara gjatë tranzicionit dhe në vijim në hapësirat detare dhe bregdetare shqiptare.

c. Zhvillimi i turizmit dhe kryesisht atij familjar duke pasur parasysh prodhimet tradicionale të zonës.

5- Forcimi i themeleve të Integritimit Evropian: Rritja e Demokracisë dhe Fuqizimi i Shoqërisë Civile.

6- Dimensioi digjital për dhunën ndaj grave.

*Shuma maksimale e financimit me grant për Projekt-Propozimet e Thirrjes 17 u përcaktua nga Bordi Mbikëqyrës deri në **2 (dy milionë) lekë** me një kohëzgjatje 6- 12 muaj;*

*Ndërkaq që **Shuma maksimale e financuar me grant Për Projekt-Propozimet për këtë Thirrje ka qenë 1.8 milionë lekë me kohëzgjatje 6-10 muaj sipas vendimit të bordit nr. 1 datë 19.02.2024***

Në Thirrjen 17 për Projekt Propozime kanë aplikuar rreth **151 OJF- aplikante**; me nje shumë totale të kërkuar nga AMSHC-ja per totalin e projekteve prej: **267,799,959 lek**

NGA KËTO:

Bordi Mbikëqyrës ka shpallur si fitues **73 Projekt Propozime** me nje shumë totale te financuar prej **96,500,000 lek**

Statistikat lidhur me shpërndarjen e projekteve në total të cilat kanë aplikuar si dhe shpërndarja e projekteve fituese sipas Fushave Prioritare në % dhe shuma e disbursuar për secilin prioritet është si më poshtë tabelat:

Shpërndarja e Projekt Propozimeve sipas fushave prioritare për OJF-të Aplikante të Thirrjes Nr. 17 (23 shkurt - 25 Mars 2024)

Tab 1

NR	Fushat Prioritare	Nr Projekteve aplikuese	Shuma e kërkuar nga AMSHC-ja per secilën fushë Prioritare
1	1- Forcimi i drejtësisë dhe llogaridhënies: qasje novatore në monitorimin e reformës në drejtësi dhe rritjen e rolit të mediave investigative në luftën kundër korrupsionit.	7	13,238,000
	a. Korrupsioni dhe lufta kunder tij.		
	b. Monitorimi i Reformës në Drejtësi dhe procesit të Vettingut.		
	c. Mbështetje për median investigative lokale.		
2	2- Fuqizimi i Gjeneratës së ardhshme: Nxitja e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve përmes promovimit të talenteve artistike, integritit në komunitet, vullnetarizmit dhe ndërgjegjësimit për shëndetin seksual.	58	104,385,473
	a. Mbrojtja e të drejtave të femijeve dhe të rinjve .		
	b. Bashkëveprimi i rinisë në fushatat sensibilizuese për promovimin e talenteve te reja ne art dhe trashëgimi kulturore .		
	c. Aktivizimi i të rinjve ne proceset integruese, vullnetarizmi dhe filantropia.		
	d. Sensibilizim i te rinjve për marrëdhënie të mbrojtura dhe të shëndetshme seksuale.		
3	3- Rritja e mirëqenies së komunitetit përmes qeverisjes lokale gjithëpërfshirëse: Forcimi i qeverisjes vendore, edukimi profesional dhe shërbimet sociale për gratë, të rinjtë, të moshuarit, minoritetet dhe njerëzit me aftësi të ndryshme.	27	48,347,710
	a. Mirëqeverisja vendore.		
	b. Mbështetje për arsimimin profesional, fuqizimin dhe punësimin e grave e të rinjve.		
	c. Përmirësimi i shërbimeve sociale.		
	d. Mbështetje për moshën e tretë, ofrimi i shërbimeve sociale në banesë, etj.		
	e. Mbështetja e minoriteteve, regjistrimi i fëmijëve rom në regjistrat e Gjendjes Civile.		
	f. Mbështetje dhe aksesueshmëria për personat me aftësi ndryshe, përfshirja sociale e personave me aftësi intelektuale.		
4	4- Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Mbrojtja e Mjedisit: Rritja e Zonave Natyrore Rajonale për Turizmin, Mbështetja e Ruajtjes së Pyjeve dhe Burimeve Termale, Promovimi i Turizmit Familjar me fokus në produktet tradicionale përballë kërcënimit të zhvillimit ekonomik.	32	59,949,036
	a. Identifikim, adresim dhe zhvillim të zonave rajonale natyrore me potenciale turistike të riskuara nga zhvillimet ekonomike të pakontrolluara.		
	b. Mbështetja e projekteve për mbrojtjen e mjedisit me fokus pyjet dhe vendburimet termale; Fokusim dhe adresim i dëmeve të shkaktuara gjatë tranzicionit dhe në vijim në hapësirat detare dhe bregdetare shqiptare.		
	c. Zhvillimi i turizmit dhe kryesisht atij familjar duke pasur parasysh prodhimet tradicionale të zonës.		

5	5- Forcimi i themeleve të Integritimit Evropian: Rritja e Demokracisë dhe Fuqizimi i Shoqërisë Civile.	8	59,949,036
6	6- Dimensioni digjital për dhunën ndaj grave.	7	119,898,072
	Me shumë se nje fushë prioritare	8	14867200
Shuma në Total e kërkuar nga AMSHC-ja		147	420,634,527

Shpërndarja e projekteve fituese sipas Fushave Prioritare të Thirrjes Nr. 17 për projekt-propozime (23 shkurt - 25 mars 2024) paraqitet sipas tabelave/grafikëve të mëposhtëm:

Shpërndarja sipas Fushave Prioritare e Projekteve fituese të Thirrjes Nr. 17
(23 shkurt - 25 Mars 2024)


Tab 2

Nr.	Fushat Prioritare	Nr. Projekteve për Prioritet	Shuma e financuar per secilin prioritet	Pesha Spcifike ne %
1	1- Forcimi i drejtësisë dhe llogaridhënies: qasje novatore në monitorimin e reformës në drejtësi dhe rritjen e rolit të mediave investigative në luftën kundër korrupsionit.	3	4,000,000	4.15
	a. Korrupsioni dhe lufta kunder tij.			
	b. Monitorimi i Reformës në Drejtësi dhe procesit të Vettingut.			
	c. Mbështetje për median investigative lokale.			
2	2- Fuqizimi i Gjeneratës së ardhshme: Nxitja e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve përmes promovimit të talenteve artistike, integritit në komunitet, vullnetarizmit dhe ndërgjegjësimit për shëndetin seksual.	33	42,300,000	43.83
	a. Mbrojtja e të drejtave të femijeve dhe të rinjve .			
	b. Bashkëveprimi i rinisë në fushatat sensibilizuese për promovimin e talenteve te reja ne art dhe trashëgimi kulturore .			
	c. Aktivizim i të rinjve ne proceset integruese, vullnetarizmi dhe filantropia.			
	d. Sensibilizim i te rinjve për marrëdhënie të mbrojtura dhe të shëndetshme seksuale.			

3	3- Rritja e mirëqenies së komunitetit përmes qeverisjes lokale gjithëpërfshirëse: Forcimi i qeverisjes vendore, edukimi profesional dhe shërbimet sociale për gratë, të rinjtë, të moshuarit, minoritetet dhe njerëzit me aftësi të ndryshme.	14	17,200,000	17.82
	a. Mirëqeverisja vendore.			
	b. Mbështetje për arsimimin profesional, fuqizimin dhe punësimin e grave e të rinjve.			
	c. Përmirësimi i shërbimeve sociale.			
	d. Mbështetje për moshën e tretë, ofrimi i shërbimeve sociale në banesë, etj.			
	e. Mbështetja e minoriteteve, regjistrimi i fëmijëve rom në regjistrat e Gjendjes Civile.			
f. Mbështetje dhe aksesueshmëria për personat me aftësi ndryshe, përfshirja sociale e personave me aftësi intelektuale.				
4	4- Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Mbrojtja e Mjedisit: Rritja e Zonave Natyrore Rajonale për Turizmin, Mbështetja e Ruajtjes së Pyjeve dhe Burimeve Termale, Promovimi i Turizmit Familjar me fokus në produktet tradicionale përballë kërcënimit të zhvillimit ekonomik.	12	16,900,000	17.5
	a. Identifikim, adresim dhe zhvillim të zonave rajonale natyrore me potenciale turistike të riskuara nga zhvillimet ekonomike të pakontrolluara.			
	b. Mbështetja e projekteve për mbrojtjen e mjedisit me fokus pyjet dhe vendburimet termale; Fokusim dhe adresim i dëmeve të shkaktuara gjatë tranzicionit dhe në vijim në hapësirat detare dhe bregdetare shqiptare.			
	c. Zhvillimi i turizmit dhe kryesisht atij familjar duke pasur parasysh prodhimet tradicionale të zonës.			
5	5- Forcimi i themeleve të Integrimit Evropian: Rritja e Demokracisë dhe Fuqizimi i Shoqërisë Civile.	5	6,800,000	7.05
6	6- Dimensioni digjital për dhunën ndaj grave.	1	1,800,000.00	1.87
7	Me shumë se nje fushë prioritare	5	7,500,000	7.8

Shuma totale e disbursuar për Projekte	73	96,500,000
--	----	------------

Grafiku 1



Siç mund të vërehet nga tabela dhe grafiku, prioriteti me përqindjen më të lartë të projekteve të zbatuara është ai nën fushën Prioritare:

Fuqizimi i Gjeneratës së ardhshme: Nxitja e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve përmes promovimit të talenteve artistike, integritit në komunitet, vullnetarizmit dhe ndërgjegjësimit për shëndetin seksual. : me një peshë specifike 43.83%

Një zë tjetër i rëndësishëm i përqindjes së peshës specifike përbën Prioriteti: Rritja e mirëqenies së komunitetit përmes qeverisjes lokale gjithëpërfshirëse: Forcimi i qeverisjes vendore, edukimi

profesional dhe shërbimet sociale për gratë, të rinjtë, të moshuarit, minoritetet dhe njerëzit me një peshë specifike: 17.82 %

Si dhe prioriteti: Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Mbrojtja e Mjedisit: Rritja e Zonave Natyrore Rajonale për Turizmin, Mbështetja e Ruajtjes së Pyjeve dhe Burimeve Termale, Promovimi i Turizmit Familjar me fokus në produktet tradicionale përballë kërcënimit të zhvillimit ekonomik me një me një peshë specifike: 17.5%

Ndërkaq, kategoria më shumë se një prioritet / fushë; e cila në përgjithësi nga statistikat ka qenë një kategori që gjithnjë ka pasur një përqindje të lartë, pasi projektet kanë qenë të një natyre më të gjerë, por që për këtë thirrje kjo kategori është në përqindjedje më të ulur krahasimisht me vitet e tjera. Pra projektet kanë qenë më të orientuar në një prioritet të caktuar (shih tab.3)

Tabelë: 3 Përblendedhëse për Projekt Propozimet fituese sipas Fushës së Prioriteteve Thirrja Nr.17

Projektpropozime sipas Fushës së Prioriteteve	Thirrja Nr.17	
	Nr Projekteve	vlerë 000/lekë
Prioriteti 1	3	4,000,000
Prioriteti 2	33	42,300,000
Prioriteti 3	14	17,200,000
Prioriteti 4	12	16,900,000
Prioriteti 5	5	6,800,000
Prioriteti 6	1	1,800,000.00
Me shume se nje fushe prioritare Total	5	7,500,000
Në 2 Prioritete	4	6,000,000
Në 3 Prioritete	1	1,500,000
Në 4 Prioritete	0	0
Në 5 Prioritete	0	0
Shuma:	73	96,500,000

SHPËRNDARJA TERRITORIALE SIPAS QARQEVE ADMINISTRATIVE E PROJEKTEVE FITUESE

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në mënyrë të vazhdueshme duke qenë se në filozofinë e në misionin e saj ka si objektiv një shpërndarje të projekteve fituese sa më të gjerë në të gjithë territorin.

Në të njejtën përjasje edhe në thirrjen e saj Nr. 17 të drejtuar OJF-ve për shprehje interesi për Projekt Propozime e ka pasur si fokus kryesor një shpërndarje territoriale sa më të gjerë në nivel kombëtar.


Në mënyrë më të detajuar për këtë shpërndarje të dhënat shprehen në tabelat dhe grafikët e mëposhtëm:

Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e Projekteve fiuese:

Tab 4

Nr.	Shtrirja në Nivel Qarku	Shpërndarja Territoriale e Projekteve Fituese sipas Qarqeve
1	Qarku i Beratit	4
2	Qarku Dibër	2
3	Qarku Durrës	8
4	Qarku Elbasan	7
5	Qarku Fier	3
6	Qarku Gjirokastrë	8
7	Qarku i Korçë	7
8	Qarku Kukës	2
9	Qarku Lezhë	7
10	Qarku Shkodër	8
11	Qarku Tiranë	28
12	Qarku Vlorë	13
13	Projekte në Nivel Kombëtar	5
Nr.Total i Projekteve te Financuara		73 Projekte ne Total ; 5 nga të cilet në nivel Kombëtar 24 projekte mbulojnë më shumë se një qark apo qytet

Grafik 2: Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese për Thirrjen 17



Ndërkaq kjo shpërndarje gjeografike e projekteve fituese sipas qyteteve të secilit Qark Administrativ paraqitet sipas tabelës dhe grafikut të mëposhtëme:

Tab:5


Shtrirja në Nivel Qarku	Shpërndarja Territoriale e Projekteve Fituese sipas qyteteve
Qarku i Beratit	4
Berat	2
Kucovë	1
Skrapar	1
Qarku Dibrë	2
Peshkopi	1
Bulqizë	1
Mat	0
Klos	0
Qarku Durrës	8
Durrës	7
Krujë	1
Qarku Elbasan	7
Elbasan	5
Gramsh	1
Librazhd	1
Peqin	0
Prrenjas	0
Cerrik	0
Qarku Fier	3

Fier	2
Lushnje	0
Mallakastër	1
Roskovec	0
Qarku Gjirokastrë	8
Gjirokastrë	5
Përmet	3
Tepelene	0
Qarku i Korçë	7
Korçë	5
Devoll	0
Pogradec	1
Kolonje	1
Maliq	0
Pustec	0
Qarku Kukës	2
Kukës	2
Tropojë	0
Has	0
Qarku Lezhë	7
Lezhë	5
Kurbini	2
Mirditë	0
Qarku Shkodër	8
Shkodër	6
Puke	1
Malësi e Madhe	0
Vau i Dejës	1
Fushë-Arrëz	0
Qarku Tiranë	28
Tiranë	26
Kamëz	1
Kavajë	1
Vorë	0
Qarku Vlorë	13
Vlorë	6
Sarandë	6
Delvinë	0
Selenicë	0
Himarë	1
Finiq	0

Konispol	0
Projekte në Nivel Kombëtar	5

Shenim: Disa projekte kane shtrirje ne me shume se nje qarke apo qytet.

Grafik:3



Siç mund të vihet re nga të dhënat tabelave/grafikëve si dhe shpërndarjes në përqindje; por edhe asaj territoriale, Projektet fituese kanë një përqëndim më të lartë të zbatueshmërisë në rrethin e Tiranës. Mbulimi për financim me projekte në përgjithësi prek të gjitha qarqet administrative. Mbulimin me përqindje më të lartë siç u përmend dhe më lartë e zë Qarku i Tiranës, më pas vijnë qarqet Berat, Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan, Durrës, Korçë etj.

KAPITULLI III

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Referuar nevojave dhe synimit për përafrimin e legjislacionit por jo vetëm, edhe strukturave shtetërore për funksionim edhe më të saktë të shoqërisë civile, Qeveria Shqiptare ndër morri iniciativën për themelimin dhe organizimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.

Misioni themelor i këtij Këshilli do të jetë garantimi i bashkëpunimit institucional me organizatat e shoqërisë civile në dobi dhe në funksion të zgjerimit të demokracisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR
PËR SHOQËRINË CIVILE**

Në vazhden e kësaj nisme, Qeveria Shqiptare, në fundvitin e 2015-ës, miratoi Ligjin Nr. 119/2015 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile”.

Veprimtaria e KKSHC-së Janar - Dhjetor 2024

AMSHC, në cilësinë e sekretariatit të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, gjatë vitit 2024 ka mbështetur organizimet e tre mbledhjeve të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, përkatësisht më 12 shkurt, 16 tetor dhe 6 dhjetor 2024. Përgjatë vitit, është dhënë mbështetje nga Delegacioni Evropian në Shqipëri për vlerësimin e masave të parashikuara në Udhërrëfyesin për Shoqërinë Civile 2019-2023”, si edhe nga zyra e OSBE-së në lidhje me vlerësimin e nevojave për ndryshimin e Ligjit nr.119/2015 për Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile.

Këshilli Kombëtar është mbledhur tre herë përgjatë vitit:

I. Mbledhja e Këshillit Kombëtar – 12 shkurt 2024

Në mbledhjen e 12 shkurtit u prezantuan dhe diskutuan gjerësisht çështjet e mëposhtme:

1. Raportim mbi veprimtarinë e KKShC-së për vitin 2023 si dhe rekomandimet dhe temat e diskutuara gjatë vitit të shkuar;
2. Problematika mbi regjistrin elektronik të OJF-ve dhe lidhja me sistemin e ri që po përgatitet nga Drejtoria e Tatim Taksave;
3. Zbatueshmëria e Ligjit që përjashton OShC-të nga detyrimi i TVSH-së ;
4. Përditësime mbi procesin e hartimit të Udhërrëfyesit të Ri për Shoqërinë Civile;
5. Propozime për kalendarin e veprimtarisë së KKShC-së për vitin 2024;
6. Si dhe diskutime mbi ndryshimet në Ligjin nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.

II. Mbledhja e Këshillit Kombëtar – 16 tetor 2024

Në mbledhjen e 16 tetorit u prezantuan dhe diskutuan gjerësisht çështjet e mëposhtme:

1. Përditësim mbi Udhërrëfyesin e ri të Shoqërisë Civile dhe Ndryshimin e Ligjit të KKSHC;
2. Diskutime mbi miratimin e Udhërrëfyesit të Ri mbi Institucionet Demokratike;
3. Proçesi integritit të Shqipërisë në BE, roli i organizatave të shoqërisë civile në këtë proçes dhe në përfshirjen e Komitetit të Përbashkët Konsultativ të shoqërisë civile;
4. Bashkëfinancimi publik për projektet e BE-së dhe formulari i përjashtimit nga TVSH për projektet e financuara nga BE;
5. Si dhe propozime mbi krijimin e Urdhërit të Profesionit të Shëndetit Publik.

III. Mbledhja e Këshillit Kombëtar – 6 dhjetor 2024

Në mbledhjen e 6 dhjetorit u prezantuan dhe diskutuan gjerësisht çështjet e mëposhtme:

1. Bashkëfinancimi publik për projektet e BE-së dhe formulari i përjashtimit nga TVSH për projektet e financuara nga BE;
2. Prezantim i ndryshimeve të parashikuara në Udhëzimin “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”
- d. Prezantimi i Raportit të Vlerësimit të Udhërrëfyesit për Shoqërinë Civile 2019-2023 - 4 Qershor 2024

Më 4 qershor 2014, në mjediset e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, u prezantua raporti i vlerësimit për Udhërrëfyesin e shoqërisë civile për periudhën 2019-2023 Përgjatë prezantimit, anëtarë të KKSHC nga shoqëria civile dhe nga institucionet shtetërore, u njohën me nivelin e përmbushjes së masave të parashikuara për një mjedis mundësues institucional për shoqërinë civile. Ky raport do të shërbejë edhe si pikënisje për Udhërrëfyesin e ri që pritet të hartohet dhe që do të shërbejë si dokumenti bazë strategjik i politikave për sektorin e shoqërisë civile.

Përgjatë muajit **nëntor dhe dhjetor**, me mbështetjen dhe ekspertizën e dhënë nga zyra e OSBE-së, u organizuan disa takime konsultative me përfaqësues të shoqërisë civile nga Qarku Shkodër, Durrës dhe Tiranë për të diskutuar mbi format organizative, sfidat dhe nevojat që kanë Këshilla të ngjashëm në rajon. Studimi krahasimor pritet të dalë në fillim të vitit 2025, dhe të shërbejë si bazë studimore për kontekstin mbi të cilin do të bëhen edhe ndryshimet ligjore në ligjin ekzistues për Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile.

KAPITULLI IV

Lista e përmbajtjes së Raportit të Monitorimit Financiar Viti 2024

1-Hyrje

2- Plani fillestar i Buxhetit Viti 2024/Informacion buxhetor i agreguar, Aneksi 1 sipas udhëzimit nr.14,dt. 30.05.2023 ”Për Proçedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qëndrore”

3- Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore

4- Performanca Financiare e programit buxhetor/ Analiza e realizimit të treguesve buxhetore 2024

5- Rishikimi i Buxhetit për Vitin 2024 nëpërmjet Akteve Normative dhe shkresave për rishikimet e buxhetit dhe rialokime fondesh brenda Programit buxhetor.

1-Hyrje

Në zbatim të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.97/2023 “Për Buxhetin e Vitit 2024” në zbatim të Udhëzimit të përhershëm të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”, në zbatim të Udhëzimit plotësues nr.1, date 24.01.2024 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", si edhe sipas Udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 ”Për Proçedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qëndrore” sipas strukturës të përcaktuar në Shtojcën 3 të Udhëzimit “Formati standart narrativ i raportit të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, raporton mbi treguesit e buxhetit dhe ecurisë së realizimit të fondeve për Vitin buxhetor 2024.

Monitorim/ Vlerësimi i performancës së treguesve Buxhetore për Vitin 2024!

Programi kryesor buxhetor I AMSHC –së si Institucion është Mbështetje për Shoqërinë Civile, me qëllim krijimin e kushteve për rritje të qëndrueshme të shoqërisë civile në vend përmes një shoqërie civile më vibrante dhe pjesëmarrëse në vendimarrje dhe monitorim politikash publike.

Politikat ekzistuese të programit të AMSHC-së, ose produktet kryesore që AMSHC prodhon në formën e shërbimeve të cilat janë tre si më poshtë listuar:

- 1- Realizimi I thirrjeve për Projekt propozime dhe financimi I projekteve të OJF- ve.
- 2-Realizim në terren I monitorimeve/inspektimeve të projekteve të financuara nga AMSHC.
- 3-Mbështetje/asistence teknike dhe informuese e OJF-ve nëpërmjet takimeve informuese/konsultative si dhe trajnimeve për rritje kapaciteti I OJF-ve.

Institucioni ka arritur objektivin e tij, mbështetjen financiare dhe monitorimin/vlerësimin e projekteve të OJF-ve sipas programeve të miratuara nga Bordi Mbikqyrës i AMSHC-së nëpërmjet menaxhimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomik të burimeve financiare dhe njerëzore të Institucionit.

Monitorimi në këtë rast është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Pra, monitorimi buxhetor është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

Me anë të këtij raporti monitorimi të Buxhetit të AMSHC - së për Vitin 2024, katër mujorin e tretë, përcjellim informacionin mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe performancën e produkteve të realizuara për Vitin 2024 përse i përket Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. Në përdorimin e fondeve buxhetore, AMSHC –ja është mbështetur në parimet e menaxhimit dhe mirëfunksionimit të sistemit buxhetor.

Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat ekonomike dhe prioritetet e AMSHC-së, duke pasur si synim një përdorim sa më efikas të këtyre burimeve, përgjegjësi të qarta për menaxhimin e shpenzimeve për çdo produkt, në funksion të realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile për vitin 2024.

2- Plani fillestar i Buxhetit Viti 2024 / Informacion buxhetor i agreguar

Në zbatim të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, Ligjin Nr.97/2023 “Për Buxhetin e Vitit 2024” në zbatim të Udhëzimit të përhershëm të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, në zbatim të Udhëzimit plotësues nr.1, date 24.01.2024 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024, si edhe sipas Udhëzimit nr.22 datë 17.11.2016 ”Për Procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”, Institucioni Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, raporton mbi treguesit e buxhetit dhe ecurisë së realizimit të fondeve për katër mujorin e dytë të vitit 2024.

Fondet buxhetore të akorduara për vitin 2024 janë në vlerën 130,525,000 lekë për shpenzime korrente dhe kapitale : fond i detajuar si më poshtë (Tab.Nr.1) nga:

EMËRTIMI	VITI 2024
Shp. Paga & Sig. Shoq.	19,820,000
Shp. të tjera korrente	106,395,000
Shp.kapitale të brendshme	1,000,000
Totali	130,525,000

Ndërkohë, në **fazën strategjike dhe teknike të përgatitjes së PBA-së** 2025-2027 dorëzuar në Maj 2024, janë përgatitur kërkesat buxhetore për dy kërkesa buxhetore të cilat do t'i shërbëjnë arritjes së objektivave të Institucionit.

➤ **Politikë ekzistuese por kërkesë për shtim fondi :**

Emërtimi: Mbështetje me fonde e më shumë projekteve të shoqërisë Civile

Kosto totale : 30,000,000 lekë

Argumentimi I nevojës për këtë politikë :

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile tashmë funksionon prej disa vitesh dhe ka mbështetur financiarisht shumë projekte të Shoqërisë Civile për një shërbim më të mirë ndaj qytetarit, për nisma civile në emër të transparencës apo luftës kundër korrupsionit duke ju përgjigjur kërkesës së shoqërisë gjithashtu edhe programeve strategjike të qeverisë.

Por, eksperiencia e deritanishme tregon se ka një hapësirë të madhe bosh mes projekteve që aplikojnë për financim pranë AMSHC-së (rreth 250 - 300 projekte) dhe atyre projekteve me cilësore të cilat AMSHC arrin të mbështesë me fonde nisur nga fondet ekzistuese që I jepen nga buxheti I shtetit (rreth 65-70 projekte ne vit) duke lënë kështu rreth 80% te projekteve që aplikojnë për fonde dhe financim pranë AMSHC –së pa mbështetje financiare!

Vlerësuar edhe në terma të një impakti të qenësishëm dhe konkret në shoqëri, AMSHC ka nevojë për më shumë fonde në llogarinë e granteve që nga një anë përbën edhe produktin kryesor të punës dhe nga ana tjetër kjo përkthehet në më shumë projekte në ndihmë dhe për grupet më të marginalizuara dhe në nevojë të shoqërisë, për monitorimin e politikave publike, për sensibilizimin e publikut në kuadër të integritimit në BE, për luftën kundër korrupsionit në çdo nivel të shfaqjes së tij pra në dobi dhe interes të qytetarëve.

➤ **Politikë ekzistuese por kërkesë për shtim fondi :**

Emërtimi: Kërkesë për shtim të fondit të llogarisë 602 të shërbimeve dhe mallrave për arsye të nevojës së Institucionit për të mbuluar pagesën e Shërbimit të ruajtjes Fizike të godinës së Institucionit

Kosto totale : 3,200,000 lekë

Argumentimi I nevojës për këtë shtim fondi :

Në këtë zë buxhetor, me kërkesë të Inspektoriatit Qëndror, Institucion I cili ndodhet në të njëjtën godinë dhe ambjent të përbashkët me AMSHC –në, na nevojiten fonde për të bërë të mundur pagesën e Shërbimit të sigurisë për ruajtjen fizike të ndërtesës, aseteve, dhe njerëzve me punonjës shërbimi, për periudhën Qershor – Dhjetor 2024, përderisa sic sqarohet në shkresën e Inspektoriat Qendror me nr.prot.241, të datës 18.04.2024 me subject “Kërkesë për likuidimin 6 mujor të kontratës për Shërbim Sigurie për ruajtjen fizike të ndërtesave, aseteve dhe njerëzve me punonjës shërbimi”(Shkresa bashkëlidhur relacionit përmbledhës të kërkesave buxhetore), ky Institucion nuk I ka mundësitë financiare për të mbuluar këtë shërbim deri në fund të vitit dhe nga ana tjetër ne si Institucion jemi të vendosur në të njëjtën godinë dhe ruajtja fizike e godinës, aseteve dhe njerëzve është detyrim ligjor.

3.Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore, në nivel produkti

Duke vlerësuar konstatimet dhe sugjerimet e Ministrisë së Financave përsa I përket Përgatitjes së PBA –së 2025-2027, Ekipi I Menaxhimit të Programit gjatë vitit 2024, ka bërë një punë të përgjegjshme në drejtim të respektimit të përcaktimeve të udhëzimit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm përshtatur specifikisht për natyrën e detyrave dhe përgjegjësive që AMSHC mbulon në bazë të Ligjit mbi të cilin është krijuar dhe funksionon tashmë prej nga Viti 2009.

- Së pari, në kuadër të pikës 3 të Udhëzimit nr.10, dt.28.02.2017 “Përfshirja e shoqërisë Civile në përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm”, ju vemë në dijeni se pjesë e planeve të punës në baza vjetore për AMSHC- në, është gjithmonë realizimi I takimeve konsultative me përfaqësues të Shoqërisë Civile në Shqipëri me qëllim njohjen me problematikat e hasura, me sugjerimet e tyre lidhur me organizimin e punës në Institucion, sugjerimet e tyre përsa I përket detajimit të zërave buxhetore si dhe përsa I përket aktiviteteve që janë të rëndësishme për t’u organizuar me qëllim përcjelljen e “feedback” të qartë të OJF-ve në punën tonë të përditshme si Institucion që mbështet fuqizimin e një Shoqërie Civile të qënësishme në vend.
- Së dyti, në vijim të punës për të realizuar me sukses buxhetimin gjinor, edhe AMSHC -ja përcaktuar produkte/objektiva/aktivitete/kosto të detajuara për arritjen e barazisë gjinore si dhe ka financuar dhe ndjekur projekte me këtë qëllim.
- Sipas sugjerimeve të Ministrisë së Financave, është shtuar tek “Objektivi I politikës së programit "Mbështetje financiare dhe monitorim për më shumë projekte të OJF- ve” sipas programeve të përcaktuara nga Bordi Mbikqyrës i AMSHC -së në vit, është shtuar tek “Tregues e Performancës për Objektivin”, objektivi “Përqindja e grave në poste drejtuese të institucionit ndaj totalit të posteve drejtuese”, objektivi I cili raportohet 50% për periudhën e raportimit pra për katër mujorin e tretë të Vitit 2024.

4.Performanca Financiare e programit buxhetor/ Analiza e realizimit të treguesve buxhetore 2024

Programi “Mbështetje për Shoqërinë Civile

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (zeri 600-601), është realizuar në zbatim të Strukturës Organizative të miratuar me Vendim nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”. Ndryshuar me Vendimin nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, mbështetur në Ligjin Nr.97/2023 “Për Buxhetin e Vitit 2024” në zbatim të Udhëzimit të përhershëm të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, në zbatim të Udhëzimit plotësues nr.1, date 24.01.2024 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", në zbatim të VKM –së Nr.39, dt. 24.01.2024 “Për Përcaktimin e numrit të Punonjësve me kontratë të përkohshme për Vitin 2024 në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, numri mesatar i punonjësve për AMSHC -në është realizuar 16 punonjës të përhershëm si dhe dy punonjës me kontratë të përkohshme.

Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shpërblimeve, si dhe i sigurimeve shoqërore, përgjatë Vitit 2024, është realizuar respektivisht;

- **19,867,397 Lekë** (zeri 600) për paga, realizimi prej 98 % për periudhën e raportimit vjetor.
- **3,186,867 Lekë** (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore shëndetsore, realizimi 96 % për periudhën e raportimit vjetor.

Fondi për shpenzime të tjera korrente (zeri 602), për vitin 2024, është planifikuar fillimisht me Ligjin e Buxhetit të Vitit 2024 në vlerën **6,395,000 leke**.

Në këtë zë buxhetor është mbështetur edhe veprimtaria dhe aktivitetet e KKSHC- së nisur edhe nga detyrat që AMSHC –ja ka përmbushur përgjatë Vitit 2024 si Sekretariat i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile duke mbuluar aktivitetet e KKSHC –së si dhe për të siguruar facilitetet logjistike për organizimin e mbledhjeve të KKSHC –së.

Ofrimi i asistencës ligjore në finalizimin e Udhërrëfyesit për Shoqërinë Civile ku AMShC ndërmori një rol të rëndësishëm në hartimin dhe mirëpërcaktimin e planit të punës dhe më gjerë. Për këtë funksion, AMShC gjithashtu ndërmori një sërë masash me qëllim realizimin sa më të saktë të tij duke përthithur produktin final (miratimin dhe zbatimin e Udhërrëfyesit).

Roli aktiv i AMShC- së në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit është një tjetër arritje e Institucionit duke ndikuar në plotësimin e masave dhe indikatorëve sa i përket Qasjes Ndërgjegjëse. Për këtë qëllim, AMShC ka tashmë programin e saj Institucional kundër Korrupsionit, një buxhet të

dedikuar për projektet anti- korrupsion. Në zërin buxhetor të AMSHC –së , disa shpenzime operative dhe të stafit i janë dedikuar edhe kësaj strategjie.

Edhe për këte zë, përgjatë kësaj periudhe raportimi është realizuar vlera në total prej **4,780,443 Lekë** Një arsye për këtë rezultat fakt të shpenzimeve të zërit shpenzime operative dhe mirëmbajtje e shërbime /llogaria 602 janë edhe procedurat e prokurimeve për blerje të vogël të vogël online të cilat janë parashikuar për t'u zhvilluar në katër mujorin e fundit të vitit 2024 duke synuar për çmimin më të ulët për blerjet dhe shërbimet në kuadër të logjistikës së përgjithshme për ecurinë normale të punës në Institucion.

Në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC-ja është mbështetur në parimin e një shpërndarje sa më racionale të kërkesave për ecurinë optimale të veprimtarisë së Institucionit si dhe ka zbatuar “*Rregjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike për Vitin 2024*” për blerje dhe shërbime të cilat kryesisht lidhen me;

- Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare e telefonike, në funksion të një veprimtarie normale institucionale.
- Kyerjen e të gjitha blerjeve për nevoja të AMSHC-së, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, lyerje dhe mirëmbajtje, pastrim etj.
- Kryerjen e pagesave për likuidimin e detyrimeve furnitorë dhe të tretë etj.
- Kryerjen e monitorimeve në terren të projekteve që AMSHC ka financuar gjatë vitit 2024.
- Realizimin e study- tour në vende të rajonit për shkëmbimin e eksperiencave më të mira për zhvillimin dhe mbështetjen e shoqërisë civile.

Fondi në zërin për Transferime Korrente të Brendshme (zëri 604), për vitin 2024 është planifikuar në vlerën **100,000,000 leke.**

Ky është dhe zëri më me peshë në strukturën e buxhetit të AMSHC- së, duke qenë se Institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grante për projektpropozimet e OJF- të përfituese. Përgjatë Vitit 2024 është zhvilluar praktika për shpalljen/vlërësimin/lidhjen e kontratave për Thirrjen për ProjektPropozime Nr.17 si rezultat i së cilës janë shpalluar nëpërmjet procesit 73 projekte fituese të cilat janë në ndjekje në vijim.

Edhe për këte zë, aktualisht **604 Kapitulli 1** për periudhën respektive është realizuar vlera prej **99,750,000 Lekë** ose **99 % e planit vjetor.**

Ndërkohë disbursimet e zërit të Granteve kanë përfshirë disbursime nga Thirrja Nr16, dhe në gjysmën e dytë të Vitit fiskal 2024 janë disbursuar Projektet fituese të Thirrjes Nr.17 organizuar nga AMSHC-ja të cilat janë aktualisht në zhvillim dhe pritet të përfundojnë përgjatë vitit 2025.

(Llogaria 604 –Disbursimi I Granteve) Gjatë vitit 2024, disbursimet e granteve më së shumti janë përqendruar në muajtë Qershor - Gusht 2024 pas shpalljes së OJF- ve fituese të Thirrjes nr.17 sipas përcaktimeve të kontratave lidhur mes OJF -ve dhe AMSHC- së.

Fondi per shpenzim investime (zeri 231) ,

1,000,000 Lekë (zeri 231) për Investime të Trupëzuara,

Gjatë katër mujorit të dytë të vitit 2024, ky zë buxhetor raportohet të jetë realizuar në vlerën 456,000 lekë pas përfundimit të procesit të prokurimit Blerje e Vogël me subjekt ”Blerje mobilie për nevojat e Institucionit”. Realizimi për këtë zë është në vlerën 45 %.

4.1. Analiza e realizimit të treguesve buxhetore për Vitin 2024

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile udhëhequr nga Bordi Mbikqyrës I AMSHC- së, ka organizuar **17 Thirrje për ProjektPropozime** sipas prioriteteve dhe fushave të cilat janë objektiva të përhershëm të Institucionit, dhe janë kryer procedurat e duhura konform Ligjeve në fuqi në lidhje me njoftimin, shpalljen, vlerësimin, seleksionimin dhe kontraktimin e Organizatave Jofitimpruese për financimin me Grante të projekteve që kanë rezultuar fituese. Më tej puna konkrete e AMSHC- së si Institucion, mbetet ndjekja e Projekteve deri në fazën finale të realizimit të tyre, Monitorimi dhe Vlerësimi I ecurisë së realizimit të Aktiviteteve konform projektpropozimit dhe kontratës së lidhur mes palëve si dhe Monitorimi dhe Vlerësimi I ecurisë së realizimit financiar të Projekteve të financuara nga AMSHC- ja dhe përputhshmëria me buxhetin e parashikuar si dhe me legjislacioni fiskal dhe tatimor të Republikës së Shqipërisë.

Veprimtaria kryesore e AMSHC- së për Vitin 2024 është përqendruar në realizimin me sukses të Thirrjeve për ProjektPropozime si dhe ndjekjes/Monitorimit/Vlerësimit të projekteve të zbatuara në kuadër të Thirrjeve për projektpropozime.

Përsa i përket realizimit të **“Output Monitoring Data”** nga targeti aktual i përditësuar përsa i takon **“Numrit të projekteve të financuara”**, nga totali prej 80 projektsh janë financuar 73 projekte nëpërmjet Thirrjes nr.17, projekte të cilat janë disbursuar 50% me lidhjen e kontratës dhe do ndiqen në vijueshmëri deri në përfundimin e tyre.

Ndërsa përsa i përket realizimit faktitk të **“Numrit të monitorimeve të kryera në terren”**, nga targeti i përditësuar prej 73 monitorimesh janë realizuar për katër mujorin e tretë të vitit 2024 janë realizuar 5 monitorime për Thirrjen nr.17 sepse periudha e katër mujorit të dytë përkon me lidhjen e kontratave të kësaj Thirrje për projektpropozime. Ndërsa në mënyrë progresive janë kryer gjithësej 31 monitorime projektsh në terren në periudhën Janar – Dhjetor 2024.

Ndërkohë, përgjatë Vitit 2024 kanë vazhduar monitorimet në terren të projekteve të cilat financohen nga AMSHC –ja, gjithashtu raportohen edhe udhëtimet e punës të realizuara përgjatë Vitit 2024 të

cilat kanë si qëllim Rritjen e pjesëmarrjes së OShC-ve në menaxhimin e instrumentit të para-aderimit në BE, bazuar në parimin e partneritetit; Koordinimin e financimeve dhe Programeve të BE prej të cilave mund të përfitojë shoqëria civile; etj

Llogaria 602 e shpenzimeve operative të stafit dhe shërbimeve është fond i cili është përdorur kryesisht për mbulimin e shpenzimeve me karakter “monitorim/vlerësim në terren të projekteve financuar nga AMSHC” , si dhe për mbulimin e eventeve me qëllim rritje kapacitetesh teknike të OJF -ve si pjesë e qëllimit afatgjatë të punës së AMSHC- së, si edhe për arritjen e objektivave më imediate si Institucion në një moment kaq të rëndësishëm për vendin tonë në tërësi si edhe për procesin e Integritimit në BE, ku përfshirja e OSHC –ve është tejet e rëndësishme !

5. Rishikimi i buxhetit për Vitin 2024 nëpërmjet Akteve Normative dhe shkresave për rialokime brenda programit.

Në këtë Fazë të raportimit të realizimit të buxhetit për Vitin 2024, fazë e cila përkon edhe me përgatitjen e PBA- së, Faza e dytë 2025-2027 , është e rëndësishme të reflektohet **ndryshimi i nevojshëm në llogarinë e pagave dhe sigurimeve për fondin total akorduar AMSHC- së sipas VKM nr.535, date 12.08.2024 “Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027”, për të përshtatur ndryshimet në klasat e pagave të stafit të AMSHC –së** sipas VKM-së nr,421, dt.26.06.2024 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shitesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nënpunësve civilë dhe nënpunësve në disa institucione të administratës publike”I ndryshuar. Ky ndryshim është reflektuar te shtojca e pagave të stafit pjesë e praktikës së PBA –së 2025 -2027 Faza e dytë, si më poshtë pasqyruar:

Kerkese per rialokim fondi të pagave 600 në zbatim të VKM -së nr.421, dt.26.06.2024									
							Viti 2024		
								Tab ne Leke	
Ent.Qeverisje	Min Linjes	Kod Institucioni	Emer Institucioni	Kapitulli	Programi	Llog.Ekon omike	Kod Thesari	Shuma	
SHTOHET									
01	88	1088001	AMSHC	01	01110	600000	3535	250,000	
TOTAL								250,000	

Gjithashtu, mbështetur në Ligjin Nr.97/2023 “Për Buxhetin e Vitit 2024” në zbatim të Udhëzimit të përhershëm të Ministrit të Financave Nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, në zbatim të Udhëzimit plotësues nr.1, date 24.01.2024 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024” si dhe për zbatimin e VKM –së nr.846, dt.26.12.2024 “Për dhënien e një ndihme të menjehershme financiare për punonjësit mbështetës të qeverisjes qendrore”,

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërise Civile ka zbatuar VKM në e lartpërmendur nga fondi në llogarine 606 nga fondi i veçantë i buxhetit të shtetit, në vlerën totale prej 60,000 lekë për zbatimin e VKM –së.

Pas ndryshimeve të kërkuar Plani i buxhetit përfundimtar për AMSHC –në për vitin 2024 është si më poshtë :


Plani i Buxhetit përfundimtar për AMShC-në – Viti 2024 pas ndryshimeve te ndodhura pergjatë vitit 2024

Fondi i Pagave (zëri 600)	20,070,000	Lekë
Fondi i Sigurimeve Shoqërore (zëri 601)	3,310,000	Lekë
Fondi për Shpenzime Operative (zëri 602)	6,395,000	Lekë
Fondi për transfertat ndaj të tretëve (zëri 604)	100,000,000	Lekë
Zëri shpërblime/ndihmë ekonomike	100,000	Lekë
Fondi për Investimet e Trupëzuara (zëri 231)	1,000,000	Lekë
TOTAL	130,875,000	Lekë


Mbi detajimin e buxhetit të këtij viti duhet theksuar detajimi në dy produkte i buxhetit akorduar AMSHC –së, të tilla si 98801AA si dhe 98801AB ku produktet të parashikuara në PBA e Vitit 2024 sipas formateve të reja kanë qenë dy të tilla si : Projekte të financuara nga AMSHC –ja si dhe Monitorime/Inspektime ne terren.

➤ Programi “Mbështetje për Shoqërinë Civile

Ecuria e realizimit buxhetor per Vitin 2024			
Struktura Buxhetore	Shpenzimet Progressive Fakt	Plani Vjetor sipas ndryshimeve te bera gjate vitit	Realizimi ne Përqindje
600 - Llogaria e pagave	19,867,397	20,070,000	99 %
601 - Kontribute sig shoq shend	3,186,867	3,310,000	96 %
602 - Shpenzime te tjera Korrente	4,780,443	6,395,000	75 %
604/1 - Tranferta GRANTE	99,750,000	100,000,000	99 %
Transferta buxhetore familjare	60,000	100,000	60%
231 - Investimet te brendshme	456,000	1,000,000	45 %
Totali	128,100,707	130,875,000	98%



Realizimi buxhetor në përqindje sipas llogarive ekonomike :




AMSHC është një Institucion qendror buxhetor i krijuar me Ligjin Nr. 10093 Date 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” dhe VKM Nr. 769 Date 15.07.2009 “Per Miratimin e Statutit të AMSHC-se” (I ndryshuar), me Mision themelor **“Nxitjen e Zhvillimit të Oëndrueshëm të Shoqërisë Civile”**, si dhe **“Krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile”**, në të mirë dhe në interes të publikut.

Për realizimin e Misionit, AMSHC-ja ofron **“asistencë financiare”** për programet, që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse, bashkëpunimin ndërsektorial e ndërkombëtar, nismat civile, filantropinë, vullnetarizmin e institucionet demokratike të shoqërisë, si dhe programe të tjera si trajnime/ëorkshops/konferenca/takime rajonale që lehtësojnë përmbushjen e misionit të Institucionit.

Duke filluar nga **muaji Nëntor 2010 e deri në fund të vitit 2024** Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile udhëhequr nga Bordi Mbikqyrës I AMSHC- së, ka organizuar **17 Thirrje për ProjektPropozime** sipas prioriteteve dhe fushave të cilat janë objektiva të përhershëm të Institucionit, dhe janë kryer procedurat e duhura konform Ligjeve në fuqi në lidhje me njoftimin, shpalljen, vlerësimin, seleksionimin dhe kontraktimin e Organizatave Jofitimprurëse për financimin me Grante të projekteve që kanë rezultuar fituese. Më tej puna konkrete e AMSHC- së si Institucion, mbetet ndjekja e

Projekteve deri ne fazën finale të realizimit të tyre, Monitorimi dhe Vlerësimi I ecurisë së realizimit të Aktiviteteve konform projektpropozimit dhe kontratës së lidhur mes palëve si dhe Monitorimi dhe Vlerësimi I ecurisë së realizimit financiar të Projekteve të financuara nga AMSHC- ja dhe përputhshmëria me buxhetin e parashikuar si dhe me legjislacionin fiskal dhe tatimor te Republikës së Shqipërisë.

Shpërndarja numerike sipas thirrjeve në përqindje:



Puna kryesore e AMSHC- së për Vitin 2024 është përqendruar në realizimin me sukses të Thirrjeve për ProjektPropozime si dhe ndjekjes/Monitorimit/Vlerësimit të projekteve të zbatuara në kuadër të këtyre Thirrjeve. Fushat prioritare të shpërndarjes së fondeve për Vitin 2024 për Thirrjen për Projektpropozime paraqiten si më poshtë vijon:

THIRRJE NR. 17 PËR PROJEKT-PROPOZIME

(23 Shkurt– 25 Mars 2024)

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), në kuadrin e konkurrimit të hapur dhe transparent sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10 093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në përputhje me statutin dhe misionin e saj: “Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut” shpall këtë Thirrje për Shprehje Interesi për të gjitha OJF-të e interesuara për depozitimin e projekt-propozimive sipas fushave prioritare.

FUSHAT PRIORITARE TË PROJEKT-PROPOZIMEVE:

1- Forcimi i drejtësisë dhe llogaridhënies: qasje novatore në monitorimin e reformës në drejtësi dhe rritjen e rolit të mediave investigative në luftën kundër korrupsionit.

- a. Korrupsioni dhe lufta kunder tij.
- b. Monitorimi i Reformës në Drejtësi dhe procesit të Vettingut.
- c. Mbështetje për median investigative lokale.

2- Fuqizimi i Gjeneratës së ardhshme: Nxitja e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve përmes promovimit të talenteve artistike, integritit në komunitet, vullnetarizmit dhe ndërgjegjësimit për shëndetin seksual.

- a. Mbrojtja e të drejtave të femijeve dhe të rinjve .
- b. Bashkëveprimi i rinisë në fushatat sensibilizuese për promovimin e talenteve të reja në art dhe trashëgimi kulturore .
- c. Aktivizim i të rinjve në proceset integruese, vullnetarizmi dhe filantropia.
- d. Sensibilizim i të rinjve për marrëdhënie të mbrojtura dhe të shëndetshme seksuale.

3- Rritja e mirëqenies së komunitetit përmes qeverisjes lokale gjithëpërfshirëse: Forcimi i qeverisjes vendore, edukimi profesional dhe shërbimet sociale për gratë, të rinjtë, të moshuarit, minoritetet dhe njerëzit me aftësi të ndryshme.

- a. Mirëqeverisja vendore.
- b. Mbështetje për arsimimin profesional, fuqizimin dhe punësimin e grave e të rinjve.
- c. Përmirësimi i shërbimeve sociale.
- d. Mbështetje për moshën e tretë, ofrimi i shërbimeve sociale në banesë, etj.
- e. Mbështetja e minoriteteve, regjistrimi i fëmijëve rom në regjistrat e Gjendjes Civile.
- f. Mbështetje dhe aksesueshmëria për personat me aftësi ndryshe, përfshirja sociale e personave me aftësi intelektuale.

4- Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Mbrojtja e Mjedisit: Rritja e Zonave Natyrore Rajonale për Turizmin, Mbështetja e Ruajtjes së Pyjeve dhe Burimeve Termale, Promovimi i Turizmit Familjar me fokus në produktet tradicionale përballë kërcënimit të zhvillimit ekonomik.

- a. Identifikim, adresim dhe zhvillim të zonave rajonale natyrore me potenciale turistike të riskuara nga zhvillimet ekonomike të pakontrolluara.
- b. Mbështetja e projekteve për mbrojtjen e mjedisit me fokus pyjet dhe vendburimet termale; Fokusim dhe adresim i dëmeve të shkaktuara gjatë tranzicionit dhe në vijim në hapësirat detare dhe bregdetare shqiptare.
- c. Zhvillimi i turizmit dhe kryesisht atij familjar duke pasur parasysh prodhimet tradicionale të zonës.

5- Forcimi i themeleve të Integritit Evropian: Rritja e Demokracisë dhe Fuqizimi i Shoqërisë Civile.

6- Dimensioi digjital për dhunën ndaj grave.

KAPITULLI V

❖ Aktivitetet kryesore të AMSHC-së për vitin 2024

Konsultimi Publik me organizatat e Shoqërisë Civile në kuadër të Shpalljes së thirrjes Nr.17

Tiranë, 29 Janar - 13 Shkurt 2024



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadër të konkurimit të hapur dhe transparent sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10 093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në përputhje me statutin dhe misionin e saj: Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile , dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut si dhe në kuadër të Ligjit Nr. 146/ 2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”;

Fillon procesin e konsultimit publik në kuadër të përcaktimit të prioriteteve mbi thirrjes e radhës në qytete e Shqipërisë si mëposhtë:

Gjithashtu fton të gjitha OJF-të e interesuara dhe të pamundura për të qënë pjesë e takimit të dërgojnë në adresën e emailit info@amshc.gov.al të gjitha sugjerimet e tyre në kuadër të prioriteteve mbi shpalljen e thirrjes nr. 17.



Zhvillohet mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Tiranë, 12 shkurt 2024

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në funksionin e Sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, njofton gjithë palët e interesuara se në datën 12 Shkurt 2024 në orën 14:00, në ambjentet e Qendrës për Hapje dhe Dialog në Kryeministri, do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile.



Ky ishte takimi i parë i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile për vitin 2024. Ku pjesëmarrës ishin anëtarët e përhershëm të Këshillit, dhe përfaqësues nga Këshilli i Lartë Gjyqësorit, SASPAC, Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, etj. Temat që u diskutuan në takim ishin:



- a) Problematika mbi regjistrin elektronik të OJF-ve dhe lidhja me sistemin e ri që po përgatitet nga Drejtoria e Tatim Taksave;
- b) Zbatueshmëria e Ligjit që përjashton OSHC-të nga detyrimi i TVSH-së;
- c) Përditësim mbi procesin e hartimit të Udhërrëfyesit të Ri për Shoqërinë Civile,
- d) Propozime për kalendarin e veprimtarisë së KKSHC-së për vitin 2024;
- e) Diskutime mbi ndryshimet në Ligjin nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”;

Shpallja e Thirrjes Nr. 17 pranë Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

Tiranë, 23 shkurt 2024

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadrin e konkurimit të hapur dhe transparent sipas kriterëve të përcaktuar në Ligjin Nr. 10 093, datë 09.03.2009 “Për organizimin dhe

funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, në përputhje me statutin dhe misionin e saj: Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile, dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut si dhe në kuadër të Ligjit Nr. 146/ 2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”; Shpall hapjen e thirrjes 17.



Gjatë takimeve të zhvilluara nga përfaqësuesit e AMSHC-së dhe OJF-ve të ndryshme apo

pushtetit vendor, janë prezantuar nga ana e institucionit tonë qëllimet e zhvillimit të takimeve dhe janë dëgjuar propozimet e tyre për prioritetet sipas fushës së veprimtarisë dhe në përfundim duke konsultuar në tërësi janë grupuar propozimet për prioritetet.

Nga diskutimet e shumta të bëra nga pjesëmarrësit në takime, përfaqësuesit e OJF-ve dhe grupet e tjera të interesit si dhe nga shqyrtimi i të gjithë materialit të marrë në rrugë elektronike dhe në formë të shkruar (hard copy), ku pjesëmarrësit listuan të gjitha sugjerimet e tyre, u arrit në përfundim se Shoqëria Civile ndeshet me problematika dhe sfida të shumta, të cilat kërkojnë zgjidhje. Duke marrë parasysh rolin e AMSHC-së në përputhje me ligjin në fuqi pasi u finalizuan takimet e programuara në



kuadër të konsultimit publik.

Sugjerimet/propozimet për prioritetet janë si më poshtë:

- ❖ Korrupsioni dhe lufta kundër tij
- ❖ Mirëqeverisja vendore.
- ❖ Monitorimi i Reformës në Drejtësi dhe procesit të vetingut.
- ❖ Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve.
- ❖ Bashkëveprimi i rinisë në fushatat sensibilizuese për promovimin e talenteve të reja në art, kulturë dhe skulpturë.
- ❖ Mbështetje dhe aksesueshmëria për personat me aftësi ndryshe, përfshirja sociale e personave me aftësi intelektuale.
- ❖ Sensibilizim, mobilizim dhe aktivizim i të rinjve në proceset integruese, vullnetarizmi dhe filantropia.
- ❖ Sensibilizimi i të rinjve në përdorimin e masave mbrojtëse nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme.
- ❖ Informimi dhe sensibilizimi mbi të drejtat e të rinjve, kryesisht në zonat rurale.
- ❖ Mbështetje për arsimimin profesional, fuqizimin dhe punësimin e grave e të rinjve.
- ❖ Identifikim, adresim dhe zhvillim të zonave rajonale natyrore me potenciale turistike të riskuara nga zhvillimet ekonomike të pakontrolluara.
- ❖ Promovimi i harmonisë dhe bashkëjetesës fetare.
- ❖ Përmirësimi i shërbimeve sociale.

- ❖ Mbështetje për moshën e tretë, ofrimi i shërbimeve sociale në banesë, etj.
- ❖ Rritja e kapaciteteve të OJF-ve për hartimin e projekteve konkrete, sidomos atyre lokale.
- ❖ Mbështetja e projekteve për mbrojtjen e mjedisit me fokus pyjet dhe vendburimet termale; Fokusim dhe adresim i dëmeve të shkaktuara gjatë tranzicionit dhe në vijim në hapësirat detare dhe bregdetare shqiptare.
- ❖ Zhvillimi i turizmit familjar duke pasur parasysh prodhimet tradicionale të zonës; turizmi alternativ/turizmi i aventurës.

Prezantimi i Raportit Paraprak të Vlerësimit për “Udhërrëfyesin për politikën e qeverisë drejt një mjedisi më mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019-2023”

Tiranë, 23 shkurt 2024

Sot në datën 04.06.2024 në mjediset e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale u bë prezantimi i raportit paraprak të vlerësimit për “Udhërrëfyesin për politikën e qeverisë drejt një mjedisi më mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019-2023”.

Ky raport vlerësimi, i cili është në fazën e tij të parë konsultative, do të shërbejë edhe si pikënisje për hartimin e dokumentit të ardhshëm strategjik për shoqërinë civile.

Në takim ishin të pranishëm anëtarë të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, përfaqësues nga zyra e Delegacionit Evropian në Shqipëri, ekspertë kombëtar dhe ndërkombëtar nga shoqëria civile si edhe përfaqësues të Asistencës Teknike për Organizatat e Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.



Programi i shkëmbimit të OJF-ve

Tiranë, 7 qershor 2024



Sot në datë 07 Qershor 2024 Partnerët Shqipëri organizuan edicionin e tretë të “Programit të Shkëmbimit të OJF-ve” në ambjentet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.



Programi synon të kontribuojë në fuqizimin e kapaciteteve të sektorit, rritjen e aksesit dhe bashkëpunimit ndërmjet OJF-ve dhe institucioneve publike e private në procesin e hartimit dhe zbatimit të nismave advokuese ne vend me qëllim adresimin e nevojave të grupeve të interesit të cilave ju shërbejnë.

Programi është një kombinim i leksioneve të diskutimit, me ekspertë e përfaqësues të institucioneve, dhe vizitave në institucione publike, private dhe OJF-ve partnere. Gjithashtu, përfaqësues të OJF-ve të përzgjedhura në program pritet të zbatojnë njohuritë e fituara në nismat e tyre lokale.

Zhvillohet EU Civile Society në Beograd

Beograd, 12 qershor 2024

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile AMSHC, marrin pjesë në forumin e Shoqërisë Civile të BE-së 2024 për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë. Programi ishte organizuar në gjashtë panele dhe projektuar Rendi i ditës përfshin seancat e mëposhtme:

- BE-ja dhe shoqëria civile në Ballkanin Perëndimor – Plani i Rritjes dhe momenti i ri për zgjerimin e BE-së.



- Nisja e Vlerësimit të dytë në kuadër të udhëzimeve të DG NEAR për Mbështetjen e BE-së për Shoqërinë Civile në rajonin e Ballkanit, për

vitin 2023.

- Një sesion Ëorld Café për temat e propozuara nga delegatët e konferencës.

Projekti është i financuar nga Asistenca Teknike BE-së për Organizatat e Shoqërisë Civile (EU TACSO 3) në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, dhe organizohet në Beograd, Serbi më 11, 12 dhe 13 qershor 2024.

Zhvillohet Konferenca e VI Kombëtare “E Drejta për Informim – Ndërtimi i besimit, Promovimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në politikat kundër korrupsionit”

Tiranë, 7 qershor 2024

Me date 26.06.2024 u zhvillua Edicioni i VI i Konferencës Kombëtare me temë “E Drejta për Informim – Ndërtimi i besimit – Promovimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në politikat kundër korrupsionit”.

Transparenca, llogaridhënia dhe aksesimi në informacion janë çelësi për ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme dhe demokratike. E drejta për të pasur akses në informacion është thelbësore në krijimin e institucioneve llogaridhënëse dhe me integritet. Nëse qytetarët janë të painformuar nuk mund të kërkojnë llogari nga qeveria e tyre për

korrupsionin në sektorin publik. Aksesimi në informacion cilësor shërben si një katalizator për një shoqëri të hapur e demokratike dhe për garantimin e të drejtave të qytetarëve.



Kjo konferencë mbledhi bashkë në formën e një tryeze diskutimi, autoritetet publike përfaqësuar nga titullarët dhe koordinatori për të drejtën për informim, koordinatori kundër korrupsionit, si dhe koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik, të institucioneve qendrore, vendore, të pavarura dhe të gjyqësorit, bashkë me ekspertë dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Roli i saj është që të shërbejë për të eksploruar rolin kritik të aksesit në informacion sipas parimeve të transparencës, gjithëpërfshirjes dhe llogaridhënies, si dhe për të diskutuar gjendjen e transparencës së autoriteteve publike shqiptare, problematikat ekzistuese, si dhe propozime për rritjen e saj në nivelet e kërkuara.

Në fokus të Konferencës ishte roli i domosdoshëm i shoqërisë civile dhe medias në promovimin e aksesit në informacion dhe transparencës dhe në formimin e institucioneve të përgjegjshme dhe me integritet, si dhe ndarja e praktikave më të mira në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies, si shtylla të qasjes parandaluese të antikorrupsionit, Për këtë arsye përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) ishin pjesë e rëndësishme e takimit.

Shpallet për konsultim draft Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024-2030

Tiranë, 12 shtator 2024



Reforma në drejtësi, është një nga prioritetet kyçe dhe të rëndësishme të Qeverisë Shqiptare, e cila synon të forcojë shtetin e së drejtës, të avancojë me reformat e nisura në sistemin e drejtësisë dhe të respektojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Në këtë kuadër, reforma në drejtësi, bazohet në një sistem drejtësie të pavarur, llogaridhënës, transparent, me integritet të lartë profesional, efikas, që mundëson

rritjen e besimit të publikut te sistemi gjyqësor dhe te ai i prokurorisë si dhe synon rritjen e cilësisë së shërbimeve të drejtësisë duke ofruar një drejtësi cilësore në nivelin dhe në përputhje me standardet e BE-së.

Me date 12.09.2024, Propozohet nga Ministri i Drejtësisë Projektakti për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, Plani i Veprimit 2024–2030 dhe Pasaporta e Treguesve (SND III në vijim), si një dokument politik i Qeverisë Shqiptare me objektivin madhor: “Konsolidimi i arritjeve të reformës në drejtësi në përputhje me standartet më të mira evropiane”. Ministria e Drejtësisë, në kuadër të procesit të konsultimit mirëpret sugjerimet nga qytetarët, ekspertë të fushës, nga të gjitha institucionet e interesuara, organizatat jofitimprurëse dhe shoqëria civile që ofrojnë kontribut në fushën e drejtësisë.

Kontributet në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektaktit, mund të përcillen nëpërmjet postës elektronike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, me anë të regjistrimit elektronik në adresën <http://ëëë.konsultimipublik.gov.al>, në adresën postare të Ministrisë së Drejtësisë, Bulevardi “Zogu I-rë”, Tiranë, në adresën e e-mailit të koordinorit për konsultimin publik greis.como@drejtesia.gov.al.

Zhvillohet mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Tiranë, 16 Tetor 2024

Mbahet mbledhja e radhës e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), e cila u organizua nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), pranë ambjenteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku kishte të ftuar organizata të shoqërisë civil



Nën drejtimin e Znj. Albana Koçiu, Kryetare e Këshillit, dhe në prezencë të anëtarëve të qeverisë, të shoqërisë civile, dhe Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, u mbajt mbledhja e dytë kombëtare e KKSHC-së për vitin 2024. Në këtë mbledhje ishte e pranishme edhe Drejtoresha Ekzekutive e Agjencisë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës Znj.Eridana Çano.

Gjatë diskutimeve u rrahën propozime dhe mendime në lidhje me çështje të mirëfunksionimit të Këshillit dhe të sektorit të shoqërisë civile.



Propozime konkrete u dhanë nga përfaqësuesit e shoqërisë civile në lidhje me:

- (i) Krijimin e urdhërit të profesionit të shëndetit publik;
- (ii) (ii) konsultimeve publike për përfshirjen e shoqërisë civile në projekt-buxhetin afatmesëm, si edhe për zbatimin e udhëzimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për rimbursimin e një sasive të caktuar m³ uji për familjet në nevojë



Programi i Shkëmbimit të OJF-ve.

Tiranë, 23 tetor 2024

Sot në 23 Tetor 2024 Partnerët Shqipëri organizuan edicionin e katërt të “Programit të Shkëmbimit të OJF-ve” në ambjentet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.



Programi synon të kontribuojë në fuqizimin e kapaciteteve të sektorit, rritjen e aksesit dhe bashkëpunimit ndërmjet OJF-ve dhe institucioneve publike e private në procesin e hartimit dhe zbatimit të nismave advokuese ne vend me qëllim adresimin e nevojave të grupeve të interesit të cilave ju shërbejnë.

Programi është një kombinim i leksioneve të diskutimit, me ekspertë e përfaqësues të institucioneve, dhe vizitave në institucione publike, private dhe OJF-ve partnere. Gjithashtu, përfaqësues të OJF-ve të përzgjedhura në program pritet të zbatojnë njohuritë e fituara në nismat e tyre lokale. Akademia është një program 9-mujor i dedikuar për Drejtues dhe Manaxherë të lartë të organizatave të shoqërisë civile, i cili synon rritjen e kapacitetit të tyre në manaxhimin organizativ dhe zhvillimin e qëndrueshëm të organizates.

KAPITULLI VI

BORDI MBIKQYRËS

Bordi mbikqyrës për të përmbushur detyrat sipas kompetencave të përcaktuara shprehimisht në ligjin Nr.10 093, datë 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, gjatë vitit kalendarik 2024 ka organizuara mbledhje ku në rendet e ditës të të cilave diskutohen një sërë objektivash dhe merren vendime.

Në mbledhjen e datës 19.02.2024, janë analizuar dhe miratuar ndryshimet në rregullore e Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, nga ana tjetër është bërë prezantimi i prioriteteve të mbledhura gjatë procesit të konsultimit publik mbi thirrjen nr. 17 si dhe procesi i shpalljes së thirrjes.

Në linkun e publikuar në faqen zyrtare të institucionet në linkun si mëposhtë gjeni informacion më të detajuar:

<https://amshc.gov.al/ep-content/uploads/2024/02/Procesverbal-19.02.2024.pdf>

në përfundim të mbledhjes Bordi mbikqyrës doli me vendimin nr. 1 i datës 19.02.2024 ku u miratuan ndryshimet në rregullore si dhe në lidhje me procesin e shpalljes se thirrjes u vendosën:

FUSHAT PRIORITARE TË PROJEKT-PROPOZIMEVE:

1- *Forcimi i drejtësisë dhe llogaridhënies: qasje novatore në monitorimin e reformës në*

2- *Fuqizimi i Gjeneratës së ardhshme: Nxitja e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve përmes promovimit të talenteve artistike, integritit në komunitet, vullnetarizmit dhe ndërgjegjësimit për shëndetin seksual.*

3- *Rritja e mirëqenies së komunitetit përmes qeverisjes lokale gjithëpërfshirëse: Forcimi i qeverisjes vendore, edukimi profesional dhe shërbimet sociale për gratë, të rinjtë, të moshuarit, minoritetet dhe njerëzit me aftësi të ndryshme.*

4- *Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Mbrojtja e Mjedisit: Rritja e Zonave Natyrore Rajonale për Turizmin, Mbështetja e Ruajtjes së Pyjeve dhe Burimeve Termale, Promovimi i Turizmit Familjar me fokus në produktet tradicionale përballë kërcënimit të zhvillimit ekonomik.*

5- *Forcimi i themeleve të Integritit Evropian: Rritja e Demokracisë dhe Fuqizimi i Shoqërisë Civile.*

6- *Dimensioni digjital për dhunën ndaj grave.*

Shuma maksimale e financimit me grant për projekt-propozim është deri në 2 (dy milionë) leke dhe kohe zgjatja 6- 12 muaj.

Mbledhja e radhës e Bordit Mbikqyrës është realizuar në datën 23.04.2024 ku u miratua edhe lista me projektet financuese të cilën aksesohet përmes linkut në faqen zyrtare

<https://amshc.gov.al/ep-content/uploads/2024/11/Vendimi-Nr.-2-I-Bordit-Mbikqyres-2024.pdf>